



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.697/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, Antigona Kqiku nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtuar nga Antigona Kqiku, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal Gjilan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan me shenjën ZL.Anr.697/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Antigona Kqiku, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën pretendon se ju kanë keqpërdorur votat në Qendrën e Votimit 0410D në vendvotimet 01-R,02-R dhe 03-D, në Qendrën e Votimit 0430D në vv 01R,02R dhe 03D si dhe në QV0437D në vv 01R dhe 02D. Kërkon nga PZAP-i të bëhet hapja e kutive dhe të bëhet numërimi i të gjitha vendvotimeve të cekura më lart.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesja e ankesës nuk e specifikon se sa vota dyshon që i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesen .

Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.697/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*